

"Pastrimi" drejt kompanive komunale, Rama: Secila komunë të mbajë përgjegjësi për territorin e saj FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PDK-ja DHE ALEANCA I BËJNË THIRRJE KURTIT: EJA NË KUVEND, KRIJOJI INSTITUCIONET, MOS U FSHEH

FAQE 4-5



Nga protesta para Qeverisë, partitë opozitare Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca kanë akuzuar sërish të

enjten kryeministrin në detyrë se po shmang përgjegjësinë për zhblokimin e institucioneve, ndërsa kërkuar që Kuvendi të

konstituohet sa më shpejt. Po ashtu PDK-ja ka dorëzuar kallëzim penal ndaj Avni Deharit për keqpërdorim të pozitës zyrtare

VDES KASAPI I SREBRENICËS RATKO MLADIC, I DËNUAR PËR GJENOCID, KRIME LUFTE E KRIME KUNDËR NJERËZIMIT F. 3



KURTI DHE ABDIXHIKU HYJNË NË NJË FAZË TË RE TË BISEDIMEVE, FLASIN PËR EMRAT E MUNDSHËM PËR PRESIDENT F. 3



AKTUALE



SHEFI I CIA-s ISHTE NË MOSKË PËR TË PARALAJMËRUAR RUSINË TË MOS E SULMOJË BALTIKUN F. 2

KËSHILLI GJYQËSOR I KËRKON HAXHIUT T'I LIROJË NGA DETYRA GJYQOTARËT E DORËHEQUR SERBË F. 7

MBI 5 MIJË KANDIDATË APLIKUAN PËR PROVIMIN E MATURËS, 4,967 APLIKIME U APROVUAN F. 3

EKONOMI



AUV URDHËRON TËRHEQJEN NGA TREGU TË QUMËSHITIT UHT LAND 3.2%, PËR SHKAK TË MYKOTOKSINËS F. 8

DAUT HARADINAJ KËRKON REAGIM URGJENT PËR SEKTORIN E QUMËSHITIT: MASAT PO E PARALIZOJNË INDUSTRIJËN F. 8

SPORT



SERBIA TËRHEQ EKIPIN 3+3, SHMANGET PËRBALLJA ME KOSOVËN F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHEFI I CIA-s ISHTE NË MOSKË PËR TË PARALAJMËRUAR RUSINË TË MOS E SULMOJË BALTIKUN

UASHINGTON, 27 GUSHT - Drejtori i CIA-s, John Ratcliffe, udhëtoi në Moskë këtë javë me qëllim për ta paralajmëruar Rusinë të mos ndërmerre sulme ndaj vendeve të NATO-s - veçanërisht Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë - mëson Radio Evropa e Lirë nga burimet e saj.

Vizita e Ratcliffe më 25 gusht, e para e tij e bërë publike në Rusi qëkurse u emërua në krye të CIA-s nën presidentin Donald Trump, vjen në një kohë kur shqetësimet për agresionin rus janë në rritje në vendet baltike.

Një diplomat baltik, i cili foli për REL-in në kushte anonimiteti, tha se zyrtarët "ishin paralajmëruar paraprakisht" për vizitën e Ratcliffe në Moskë.

Rusia e ka konfirmuar vizitën. Sergei Naryshkin, drejtori i Shërbimit të Jashtëm të Inteligjencës të Rusisë, tha se kishte zhvilluar një "takim pune" me drejtorin e CIA-s. Ai nuk dha hollësi të tjera, duke thënë vetëm se ata diskutuan çështje të ndjeshme, të paspecifikuara.

Druajtjet e Baltikut

Udhëheqësit e Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë - të gjitha vende anëtare të NATO-s - kanë

paralajmëruar prej kohësh për agresionin rus.

REL-i raportoi më 26 gusht për një letër drejtuar presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe të nënshkruar nga tre komisionarë baltikë - Kaja Kallas, Andrius Kubilius dhe Valdis Dombrovskis - në të cilën paralajmërohej për "përkeqësimin e mjedisit të sigurisë" në Baltik dhe shtimin e "shkeljeve të hapësirës ajrore dhe inkursioneve të dronëve" nga Rusia.

Letra u nënshkrua gjithashtu nga komisionarët e Polonisë dhe Finlandës në BE.

Diplomatë baltikë, të cilët folën për REL-in në kushte anonimiteti, thanë se gjatë verës kishte pasur informacione të tjera të inteligjencës për operacione ruse nën flamur të rremë, por nuk kishte asnjë tregues për ndonjë sulm të afërt konvencional.

Vitet e fundit, Rusia ka zhvilluar një fushatë hibride kundër vendeve baltike, duke përfshirë testimin e hapësirës ajrore, luftën elektronike, sabotazhin dhe operacionet kibernetike.

Në shtator 2024, një dron rus Shahed, i armatosur plotësisht, u rrëzua në Letoni. Riga thirri të



ngarkuarin me punë të Rusisë, i cili mohoi se droni i përkiste Rusisë.

Më vonë po atë vit, kabloja elektrike Estlink 2, që lidh Finlandën me Estoninë, u dëmtua, së bashku me katër kablllo telekomunikacioni. Autoritetet finlandeze dyshuan se cisterna Eagle S, me flamur të lshujve Kuk dhe që besohet se është pjesë e "flotës në hije" të Rusisë, shkaktoi dëmin duke tërhequr spirancën e saj përgjatë shtratit të detit.

Në shtator 2025, tre avionë luftarakë rusë hynë në hapësirën ajrore të Estonisë për

rreth 12 minuta pranë ishullit Vaindlo, duke fluturuar pa plane fluturimi dhe pa transponderë. Tallini e cilësoi inkursionin si të qëllimshëm, duke iu referuar gjithashtu shkeljeve të mëparshme, dhe aktivizoi nënin 4 të NATO-s, i cili përcakton mbajtjen e detyrueshme të një takimi të vendeve anëtare të aleancës, por është më pak serioz se neni 5.

Një incident i ngjashëm ndodhi në tetor 2025, kur një avion luftarak rus dhe një avion cisternë për furnizim me karburant hynë për pak kohë në hapësirën ajrore të Lituanisë,

duke shkaktuar ngritjen në ajër të avionëve të NATO-s.

Dronët ukrainas, të cilët synojnë të godasin objektiva në Rusi, kanë hyrë rregullisht në hapësirën ajrore të Letonisë gjatë vitit 2026. Ushtria letone ka thënë se dyshon se Rusia po përdor luftën elektronike për t'i devijuar dronët.

Ndërkohë, zyrtarë amerikanë konfirmuan për REL-in se Uashingtoni do t'i njoftojë aleatët për hollësitë e vizitës së Ratcliffe javën e ardhshme.

Shefi i CIA-s u pa duke dalë nga krahua perëndimor i Shtëpisë së Bardhë më 26 gusht, së bashku me shefin e Pentagonit, Pete Hegseth, dhe kryetarin e Shefave të Shtabeve të Përgjithshme, gjeneralin Dan Caine.

Elbridge Colby, nënsekretari amerikan i Mbrojtjes për Politikën, do të takohet me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, në selinë e aleancës në Bruksel më 29 gusht.

Më pas, Colby do të marrë pjesë në një takim të Këshillit të Atlantikut të Veriut me ambasadorët e vendeve aleate.

MBI 1.300 PERSONA TË ZHDUKUR, NUMRI I VIKTIMAVE NGA PËRMBYTJET NË KUFIRIN NEPAL-KINË RRITET NË 168

KATHMANDU, 27 GUSHT - Turistët e zhdukur raportohet se përfshijnë rreth 300 nga India, 54 nga SHBA-ja, 34 nga Australia, 33 nga Britania, 17 nga Malajzia dhe 8 nga Koreja e Jugut. Vazhdojnë operacionet e kërkim-shpëtimit, të mbështetura nga helikopterë dhe dronë, ndërsa numri i viktimave nga përmbytjet shkatërruese të rrëmbyeshme përgjatë kufirit Nepal-Kinë u rrit në 168 dhe mbi 1.300 persona mbeten të zhdukur, transmeton Anadolu.

Autoriteti Kombëtar i Nepalit për Reduktimin dhe Menaxhimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë konfirmoi 165 viktima dhe tha se 826 persona mbeten të zhdukur, përfshirë turistë, shtetas të huaj, zyrtarë civilë, ushtarë, policë dhe banorë lokalë.

Turistët e zhdukur raportohet se përfshijnë rreth 300 nga India, 54 nga SHBA-ja, 34 nga Australia, 33 nga Britania, 17 nga Malajzia dhe tetë nga Koreja e Jugut.

Autoritetet kineze konfirmuan tre viktima, ndërsa 558 persona mbeten të zhdukur.

Sipas pamjeve satelitore, përmbytjet mund të jenë shkaktuar nga shkaputja e një mase të madhe akulli nga një akullnajë e Himalajeve, rreth 20 kilometra në verilindje të pikës kufitare Rasuwa-Rasuwadhi. Shkaputja bëri që tonelata akulli



dhe shkëmbinjtë të binin në lumin Bhotekoshi. Qeveria nepaleze tha se po zhvendos banorët e prekur dhe po mobilizon ushtrinë dhe operatorët privatë të helikopterëve për operacionet e kërkim-shpëtimit.

Ushtria nepaleze dhe operatorët privatë të helikopterëve kanë transportuar me rrugë ajrore 114 persona në vende të sigurta.

Sipas të dhënave fillestare,

përmbytjet shkatërruan 19 ura dhe një segment prej 40 kilometrash të një autostrade kryesore, duke ndërprerë rrugët e transportit dhe duke vështirësuar përpjekjet e shpëtimit.

Rreth 300 indianë mes të zhdukurve

Khanal i tha veçmas transmetuesit indian NDTV se

"rreth 300 indianë janë raportuar të zhdukur dhe qeveria po përpjeket të vendosë kontakt me ta".

Ai tha gjithashtu se shtetas të huaj, përfshirë indianët, përdorin rrugën në zonën e prekur për Masarovar Yatra, një pelegrinazh i shenjtë për hindusët.

Qeveria shpalli rrethet Rasuwa, Nuwakot dhe Dhading "zona të krizës nga fatkeqësitë" për një periudhë tremujore.

Autoriteti Kombëtar për Reduktimin dhe Menaxhimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë u kërkoi operatorëve të helikopterëve dhe dronëve të koordinojnë përpjekjet e shpëtimit me administratat e distrikteve, agjencitë e sigurisë dhe qeveritë lokale.

Tri viktima dhe 558 të zhdukur në Tibet

Të paktën tre persona kanë humbur jetën dhe 558 mbeten të zhdukur në rrethin Gyirong të Kinës pas fatkeqësisë së shkaktuar nga rrëshqitjet e dheut, raportoi të enjten media shtetërore kineze.

Rrëshqitja e dheut goditi pikën kufitare Gyirong në rajonin autonom jugperëndimor Xizang, i njohur gjerësisht si Tibet, raportoi agjencia e lajmeve Xinhua me seli në Pekin.

Një grup drejtuesish nga Ushtria Çlirimtare Popullore e Kinës u dërgua të enjten në zonën e prekur për të koordinuar operacionet e përbashkëta të shpëtimit nga personeli ushtarak.

Pika kufitare Gyirong është pika kryesore e kalimit për turistët dhe trafikun mes Kinës dhe Nepalit.

KURTI DHE ABDIXHIKU HYJNË NË NJË FAZË TË RE TË BISEDIMEVE, FLASIN PËR EMRAT E MUNDSHËM PËR PRESIDENT



Prishtinë, 27 gusht - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) në pushtet, Albin Kurti, dhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në opozitë, Lumir Abdixhiku, kanë biseduar për “emra konkretë” për presidentin e ardhshëm të Kosovës, por nuk pranuan t’i bëjë të ditur ata për shkak të “ndjeshmërisë” së bisedimeve.

Kurti, kryeministër në detyrë, dhe Abdixhiku, u takuan të mërkurën në përpjekje për ta arritur një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, që do t’i jepte fund krizës pothuajse dyvjeçare institucionale. “Do të vazhdojnë bisedimet për shkak se është rritur mirëbesimi dhe është hera e parë që kemi diskutuar me dhe për emra të përvëçëm”, tha Kurti pas takimit pothuajse treorësh në Prishtinë. Ai tha se “jemi në një fazë të re, kur po bisedojmë për dhe me emrat konkretë e të përvëçëm, të cilët nuk mund të behën publik derisa të ketë pajtueshmëri për ta dhe me ta”.

Derisa nuk pranoi të flasë për karakteristikat e kandidatëve, Kurti tha se “të gjithë janë në përputhje me atë që jemi pajtuar sa i përket kritereve, standardeve, parimeve, vlerat, meritave dhe kontributeve”. “Pra, të gjithë janë personalitete të mira, ka edhe shumë të mira, por ne duhet ta zgjedhim atë që është i/e shkëlqyeshme”, theksoi Kurti.

Edhe Abdixhiku theksoi se emrat e shtjelluar në takim “mund ta them me bindje të plotë se të gjithë, në masë të madhe, janë në vijë me parimet e dakorduara deri më tani”.

Ai shtoi se, për shkak të ndjeshmërisë së procesit, nuk mund të thotë se cilët janë emra konkretë në këtë fazë, “por do të takohemi sërish për të finalizuar dhe për të zgjedhur presidentin e ardhshëm të Kosovës”.

Ndërkohë, Kurti paralajmëroi për bisedime të vështira në vazhdim, duke thënë se tani “ne duhet të bisedojmë hollësisht e gjerësisht” për shkak të numrit të emrave që palët mund t’i sjellin në tryezë.

Për shkak të mospajtimeve mes partive parlamentare për pasardhësin e Vjosa Osmanit – mandati presidencial së cilës përfundoi në prill – Kosova mbajti zgjedhje të parakohshme në qershor.

Dhe ajo rrezikon të mbajë sërish zgjedhje, që do të ishin të katërtat parlamentare në dy vjetet e fundit, nëse nuk zgjidhet presidenti i ri deri në fillim të shtatorit.

LVV-ja dhe LDK-ja, pas dështimit të bisedimeve për bashkëpunim qeveritar, kanë mbajtur një takim ku kanë diskutuar për profilin e presidentit të ardhshëm dhe kanë thënë se synojnë që në takimin e radhës të dalin me emra konkretë.

Deri më tani, në media kanë qarkulluar disa emra për postin e presidentit.

Emri i profesorit Ibrahim Berisha dhe i ish-nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës në vitin 1990, Ilaz Ramaji, u përmendën, por që të dy mohuan përfshirjen në proces. Po ashtu është përmendur edhe

emri i ish-presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu.

Ndërkaq, ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka propozuar emrin e ish-presidentit Hashim Thaçi për president.

Thaçi gjendet në paraburgim në Hagë duke pritur vendimin – që shpallet më 16 shtator – në rastin kundër tij dhe ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli e Jakup Krasniqi dhe ish-deputetit Rexhep Selimi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Ndërkaq, ish-ambasadori i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Ëlilam Ğalkër, ka propozuar që president të bëhet Faton Bislimi, nga radhët e LDK-së.

Ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, sipas Kushtetutës mund ta ushtrojë këtë post vetëm për gjashtë muaj – pra deri më 4 tetor. Akti më i lartë juridik në vend nuk ka paraparë e çfarë ndodh nëse përfundon kjo periudhë dhe

vendi s’ka president të ri.

Çështja e presidentit ishte pika më e nxehtë edhe në bisedimet e dështuara për bashkëqeverisje mes LVV-së dhe LDK-së.

Tani, LVV-ja kërkon president konsensual, ndërkaq LDK-ja po ashtu kërkon që kreu i ri i shtetit të mos jetë i lidhur me ndonjë parti politike.

Partia e Kurtit i fitoi 53 mandate në zgjedhjet e fundit dhe, së bashku me partitë e komuniteteve joshumicë, i ka votat e mjaftueshme prej të paktën 61 sosh, për të konstituuar Kuvendin dhe krijuar Qeverinë e re.

Megjithatë, nevojitet prania e 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende që votimi për presidentin e Kosovës të jetë i vlefshëm.

Me një marrëveshje të mundshme me LDK-në për çështjen e presidentit, e cila i fitoi 18 vende, atëherë do të arriheshin të paktën 81 vota, mjaftueshëm për votimin e presidentit të ri, nëse të paktën 80 prej tyre do të qëndronin në sallë.

Mbi 5 mijë kandidatë aplikuan për Provimin e Maturës, 4,967 aplikime u aprovuan

Prishtinë, 27 gusht - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka njoftuar se gjithsej 5,033 kandidatë kanë aplikuar për Provimin e Maturës përmes platformës eKosova, ndërsa pas shqyrtimit dhe verifikimit janë aprovuar 4,967 aplikime.

Provimi i Maturës do të mbahet të shtunën, më 29 gusht 2026, duke filluar nga ora 10:00, në gjithsej 55 qendra të testimit.

Sipas njoftimit të Ministrisë, të gjithë komisionarët dhe administruesit duhet të jenë të pranishëm në qendrat përkatëse një orë para fillimit të provimit, me qëllim të sigurimit të organizimit dhe mbarëvajtjes së procesit.

Ndërkohë, kandidatët duhet të paraqiten në qendrën e testimit të përcaktuar në listat përfundimtare dhe të kenë me

vete dokumentin përkatës të identifikimit.

Ministria e Arsimit ka kërkuar nga të gjithë pjesëmarrësit që të respektojnë udhëzimet dhe rregullat e përcaktuara për administrimin e Provimit të Maturës.

Qëllimi, sipas MASH-it, është që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt, të sigurt dhe të barabartë për të gjithë kandidatët.





PDK-ja DHE ALEANCA I BËJNË THIRRJE KURTIT: EJA NË KUVEND, KRIJOJI INSTITUCIONET, MOS U FSHEH

Nga protesta para Qeverisë, partitë opozitare Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca kanë akuzuar sërish të enjten kryeministrin në detyrë se po shmang përgjegjësinë për zhbllokimin e institucioneve, ndërsa kërkuar që Kuvendi të konstituohet sa më shpejt. Po ashtu PDK-ja ka dorëzuar kallëzim penal ndaj Avni Deharit për keqpërdorim të pozitës zyrtare

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca kanë kërkuar sërish të enjten që kryeministri në detyrë, Albin Kurti, të shkojë në Kuvend dhe të mundësojë konstituimin e institucioneve të reja.

Kjo thirrje u bë gjatë protestës së PDK-së para objektit të Qeverisë, ku deputetë dhe përfaqësues të opozitës thanë se Kosova nuk ka më kohë për të humbur.

Ata akuzuan Kurtin se po shmang përgjegjësinë për zhbllokimin e institucioneve. Asamblisti i PDK-së nga Komuna e Shtimes, Demokrat Mujota, tha se institucionet e Kosovës janë ndërtuar përmes sakrificës së qytetarëve dhe se ato nuk duhet të bllokohen.

“Me i tregu Albin Kurtit që nuk e ka mirë, nuk e ka pasë mirë, nuk e ka mirë edhe nuk është tu shku puna mirë, për atë çka kemi qenë, jemi edhe për atë ku mendojmë të shkojmë nesër. Albini duhet me e ditë që ky popull ka sakrificë shumë. Ky popull ka dhënë gjak shumë. Ky popull ka dhënë shumë jetë për me pasë pavarësi, për me pasë liri, për me pasë të drejta, për me pasë shtet, për me pasë institucione, me pasë rend, ligj e drejtësi. Nuk bëhet hajgare me institucionet e vendit që kemi ndërtuar me shumë gjak, me shumë mund e me shumë sakrificë. Albin, nuk kemi gjak për me shkelë, as nuk kemi Republikë për me humbë. Duhet me ditë ti edhe komplet soji yt”, tha Mujota. Deputeti i PDK-së, Artan Behrami, e akuzoi Kurtin se po

shmanget nga përgjegjësia, duke e lidhur këtë me qëndrimet e tij politike ndër vite. “Sot Albin Kurti, ashtu siç e ka edhe traditë edhe në doktrinën e tij politike, sërish po fshihet, sërish iku përmes rrugëve ilegale, klandestine, duke hyrë në ndërtesën e Qeverisë. Dhe fshehja, sa është doktrinë e tij politike, Albin Kurti është fshehur në Rambuje, kur ne theksuam nënshkrimin e lirisë sonë; Albin Kurti është fshehur në Vjenë, kur ne e negociuam pavarësinë tonë; Albin Kurti është fshehur në ditën kur flamuri ynë u prezantua në Kuvendin e Republikës; Albin Kurti u fsheh në ditën e shpalljes së pavarësisë; u fsheh në ditën kur Kosova e intonoi himnin e saj, u fsheh në ditën e ushtrisë. Pra, i shkoi jeta duke u fshehur nga përgjegjësia që

ka edhe me Kushtetutë, edhe me ligj”, tha Behrami.

Ndërkaq, deputetja e Aleancës, Albana Bytyqi, tha se deputetët i kanë votat e nevojshme për konstituimin e Kuvendit dhe kërkoj që Kurti të paraqitet në sallën e Kuvendit. “Sot jemi këtu prapë para Qeverisë, për ta thirrur zotin Albin Kurti të vijë t’i bëjë institucionet. Ne e dimë që është brenda. Ne e pamë që prapë i kemi votat për konstituimin e Kuvendit. Atëherë i bëjmë thirrje edhe një herë të vijë, ta bëjë konstituimin dhe pastaj të vazhdojë për zgjedhjen e presidentit. Nuk kemi kohë. Kosova ka humbur shumë kohë. Që dy vite jemi pa institucione, kështu që është momenti i duhur të vijë në Kuvend e të krijojë institucionet. E dimë që mbrojtja e Kushtetutës, jemi këtu për ta mbrojtur Kushtetutën dhe gjithashtu do të vazhdojmë ta mbrojmë Kushtetutën dhe asnjëherë nuk do të ndalemi derisa të krijohen institucionet”, tha Bytyqi.

Opozita ka paralajmëruar se do të vazhdojë të kërkojë konstituimin e Kuvendit dhe krijimin e institucioneve të reja, duke e konsideruar zhbllokimin e situatës institucionale si çështje urgjente.

PDK-ja dorëzon kallëzim penal ndaj Avni Deharit për keqpërdorim të pozitës zyrtare

Partia Demokratike e Kosovës ka paralajmëruar se të enjten do të dorëzojë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës kallëzim penal ndaj deputetit Avni Dehari, në cilësinë e kryesuesit të përkohshëm të seancës konstituive të Kuvendit. Në një konferencë për media, deputeti i PDK-së, Përparim Gruda, bëri të ditur se kallëzimi do të dorëzohet mbi bazën e dyshimit për kryerjen e veprës penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, sipas nenit 414 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. “Nuk

VDES KASAPI I SREBRENICËS RATKO MLADIQ, I DËNUAR PËR GJENOCID, KRIME LUFTË E KRIME KUNDËR NJERËZIMIT

Ish-komandanti i ushtrisë serbe të Bosnjës, Ratko Mlladiq, i dënuar nga një gjykatë ndërkombëtare për gjenocid dhe krime kundër njerëzimit të kryera gjatë luftës në Bosnje më 1992-1995, ka vdekur në moshën 84-vjeçare. Lajmi u bë i ditur nga Radio Televizioni i Republikës Sërpska.

Mlladiq ishte dënuar për një akuzë për gjenocid, për pesë akuza për krime kundër njerëzimit dhe katër akuza për krime luftime nga Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi (ICTY) në Hagë më 2017 - mbi 20 vjet pasi ndaj tij u ngrit aktakuzë.

I njohur nga viktimat e tij dhe të tjetër si “kasapi i Bosnjës”, gjykata e gjeti Mlladiqin fajtor për urdhërimin e masakrimit të më shumë se 7.000 burrave dhe djemve në Srebrenicë më 1995 – mizoria më e madhe e kryer në Evropë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore.

Që nga vendimi i Tribunalit në Hagë, numri i viktimave nga gjenocidi në Srebrenicë është rritur në mbi 8.000.

Mlladiq po ashtu u shpall përgjegjës nga Tribunali edhe për rrethimin dhe bombardimin e kryeqytetit të Bosnjës, Sarajevë – një krim kundër njerëzimit që sipas gjykatës ndërkombëtare rezultoi me vdekjen e 4.548 ushtarëve boshnjakë dhe 4.954 civilëve. Vlerësohet se po ashtu 50.000 persona ishin plagosur gjatë rrethimit.

Tribunali i Hagës gjeti po ashtu presidentin e kohës së luftës në entitetin serb të Bosnjë e Hercegovinës, Republikës Sërpska, Radovan Karaxhiq, se kishte ndërmarrë politika që çuan në akte të gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit, ndërkaq Mlladiq, komandanti i tij kryesor i ushtrisë, sipas gjykatës, i kishte ekzekutuar këto plane.

Mlladiq dhe Karaxhiq u akuzuan se kishin udhëhequr një zinxhir komandues mbi operacionet me qëllim spastrimin etnik të Bosnjës nga joserbët, përmes torturës, frikësimit, dëbimeve të detyruara të popullsisë dhe vrasjeve masive.

I cilësuar nga nacionalistët serbë dhe shumë serbë të Bosnjës si hero, Mlladiq komandoi forcat serbe të Bosnjës gjatë luftës në Bosnjë më 1992-1995, konflikti në të cilin janë vrarë më shumë se



100.000 persona.

Tribunali i Hagës konstatoi se kur Srebrenica ra në duart e forcave serbe të Bosnjës në korrik të vitit 1995, Mlladiq dha urdhra të drejtpërdrejta që trupat serbe të Bosnjës të grumbullonin dhe të ekzekutonin burrat dhe djemtë boshnjakë, që po përpqeshin të largoheshin nga zona.

Gjykata po ashtu gjeti se forcat serbe të Bosnjës më pas tentuan të fshihnin dëshmitë e gjenocidit duke rivarrosur trupat e viktimave në varre masive, të shpërndara në zona të izoluar rurale përreth Srebrenicës.

Gjenocidi në Srebrenicë ishte edhe më tronditës për shkak se qyteti ishte vlerësuar nga Kombet e Bashkuara si zonë e sigurt për refugjatët, të cilët po iknin nga lufta në pjesë të tjera të Bosnjë e Hercegovinës.

Trubunali tha se Mlladiq kishte udhëhequr rrethimin e Sarajevës, që nisi në prill të vitit 1992 dhe zgjati për më shumë se tre vjet.

Në fakt, bllokada e Sarajevës nga trupa nën komandën e Mlladiqit zgjati nga prilli i vitit 1992 deri në shkurt të vitit 1996 – më shumë se dy muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit që i dha fund luftës. Atëbotë, ky ishte rrethimi më i gjatë i një qyteti në luftën moderne.

Karaxhiq u dënua për gjenocid më 2016, përfshirë edhe për

gjenocidin në Srebrenicë, dhe u dënua me 40 vjet burgim. Apeli i tij ndaj vendimit të gjykatës u refuzua në mars të vitit 2019 dhe dënimi iu rrit në burgim të përjetshëm.

Mlladiq iu shmang arrestimit për 16 vjet me ndihmën e ushtrisë serbe, të aleatëve të tij të kohës së luftës dhe të familjes së tij.

Ai u arrestua në maj të vitit 2011 në fshatin Llazarevo, afër qytetit të Zrenjaninit në veri të Serbisë, pasi një informacion anonim iu dërgua Policisë nga dikush që kishte thënë se kishte parë një burrë që i përngjante në Mlladiqin.

Nga nisja e gjykimit ndaj tij në maj të vitit 2012, Mlladiq u deklarua i pafajshëm. Në një moment në fillim të procesit gjyqësor, Mlladiq bëri me duar gjestin e prerjes së fytit duke u drejtuar një nënë të një prej viktimave të gjenocidit në Srebrenicë. “Mlladiq vuri në lëvizje, nën kontrollin e vartësve të tij oficerë, operacionin në shkallë të gjerë, të mirëorganizuar që la të vrarë shumë se 7.000 burra dhe djem brenda pak ditësh”, deklaroi prokurori i Tribunalit të Hagës, Dermot Groome gjatë gjykimit.

“Krimet e kryera renditen në ndër më të tmerrshmet në historinë e njerëzimit dhe përfshijnë gjenocid dhe shfarosje, si krim kundër njerëzimit”, deklaroi gjyqtari kryesor Alphons Orie teksa lexoi përmbledhjen e vendimit ndaj

Mlladiqit në nëntor të vitit 2017. “Shumë nga këta burra e djem u mallkuan, u ofenduan, u kërcënuan dhe u detyruan të këndonin këngë serbe dhe u rrahën teksa prisnin ekzekutimin e tyre”, tha Orie.

Kryeprokurori i Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavi, Serge Brammertz, e cilësoi vendimin si “arritje të madhe” sepse ai e mbante përgjegjës Mlladiqin edhe për ndalimin e dhjetëra mijëra joserbëve në kampe ku shumë u rrahën e u përdhunuan, dhe po ashtu e mbante përgjegjës për zhvendosjen e mbi 1 milion personave në përpjekje për të rishkruar hartën demografike të Bosnjës.

Mlladiq ishte larguar nga gjykatorja disa minuta para se të lexohej vendimi për shkak se ai kishte nisur të bërtiste me zemërim: “Gjithçka që ju keni thënë është gënjeshtëri e pastër. Turp. Të gjitha janë gënjeshtër”. Pas shpalljes së vendimit, viktimat dhe anëtarët e grupit të viktimave, Nënati e Srebrenicës, thanë se shpresonin që vendimi do të ndihmonte në pajtim, edhe pse shprehën keqardhje që Mlladiq nuk u shpall fajtor për të gjitha akuzat që u ngritën ndaj tij.

Familjarët që humbën më të dashurit e tyre në gjenocidin në Srebrenicë thanë se nuk kishte një dënim të duhur për të ndëshkuar Mlladiqin. “Edhe nëse do të jetonte 1.000 herë dhe do të dënohej 1.000 herë

me burgim të përjetshëm, drejtësia prapë nuk do të ishte vendosur”, u shpreh para shpalljes së vendimit, Ajsa Umiroviq, e cila humbi 42 të afërm në gjenocidin në Srebrenicë.

Vendimi ndaj Mlladiqit ishte i fundit i shpallur nga Tribunali, i cili u themelua në Hagë më 1993 për të ndjekur krimet e kryera në luftërat në Ballkan në fillim të viteve '90.

Në qershor të vitit 2021, Gjykata e OKB-së në Hagë refuzoi apelin e dorëzuar nga Mlladiq dhe konfirmoi vendimin për burgim të përjetshëm.

Vitin e kaluar, Tribunali për krime të luftës i OKB-së refuzoi kërkesën e Mlladiqit për lirim urgjent në Serbi për shkaqe shëndetësore. Në vendim, gjykata tha se gjendja e Mlladiqit, ndonëse e pasigurt, ishte e qëndrueshme dhe trajtimi i tij në burgun në Hagë ishte në një standard të pranueshëm.

Mlladiq u lind më 12 mars 1942 në Kallinovik, që atëbotë ishte pjesë e Shtetit të Pavarur të Kroacisë - një shtet kukull i Gjermanisë Naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Si anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, Mlladiq nisi karrierën e tij në Ushtrinë Popullore Jugosllave më 1965. Ai u bë figurë e njohur gjatë luftërave në Ballkan që shpërthyen pas shpërbërjes së Republikës Federative të Jugosllavisë.

mund të ketë asnjëherë një situatë ku një person publik ka autorizime zyrtare, të cilat nuk i përdorë ose i përdorë në mënyrë kundërligjore dhe të mos ketë pasojë. Ne jemi shoqëri e organizuar në shtet, nuk jemi shoqëri e organizuar në fis. Prandaj, z. Dehari duhet ta dijë që nuk është i pari i fisit, por është kryesues i një organi

të shtetit dhe kërkohet që të veprojë”, tha Gruda.

Në kallëzimin e PDK-së, Dehari, në cilësinë e deputetit më të vjetër në moshë dhe kryesuesit të seancës konstituive të Legjislaturës XI, dyshohet se nga 8 gushti 2026 e në vazhdim nuk e ka përmbushur detyrën e tij për vazhdimin e seancës

konstituive brenda afatit prej 48 orësh.

PDK-ja vlerëson se Dehari ka tejkaluar kompetencat e rolit të tij procedural duke e kushtëzuar vazhdimin e seancës me arritjen e një “marrëveshjeje politike”, pavarësisht kërkesave të përsëritura me shkrim nga grupet parlamentare

opozitare.

Në kallëzim përmenden kërkesat e opozitës të datave 13, 17, 19 dhe 23 gusht, përmes të cilave është kërkuar vazhdimi i seancës konstituive. PDK-ja vlerëson se mosvazhdimi i seancës ka pamundësuar konstituimin e Kuvendit dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar ndaj

Qeverisë në dorëheqje, ndërsa veprimet e Deharit i kanë shërbyer kësaj agjende.

Deputeti Përparim Gruda tha se PDK pret nga Prokuroria Speciale trajtimin e kallëzimit në përputhje me ligjin dhe zbardhjen e përgjegjësisë së mundshme penale lidhur me bllokimin e procesit të konstituimit të Kuvendit.

Edhe në Vushtrri nisi "Ora e Pritjes" për çlirimtarët

VUSHTRRI, 27 GUSHT - Edhe në Vushtrri ka nisur "Ora e Pritjes", aktiviteti simbolik i numërimit mbrapsht në pritje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Në aktivitetet morën pjesë qytetarë të shumtë, ndërsa të pranishmëve iu drejtuan kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, dhe përfaqësuesja e platformës qytetare "Liria ka Emër", Eliza

Hoxha.

Kryetari Idrizi tha se Vushtrria i bashkohet mesazhit të pritjes dhe mbështetjes për çlirimtarët. "Edhe Vushtrria sonte i bashkohet numërimit mbrapsht. Ky qytet e njeh mirë çmimin e lirisë dhe do të jetë pjesë e kësaj pritjeje me shpresën që çlirimtarët tanë të kthehen sa më parë në Kosovë.", tha Idrizi.

Ndërkaq, Eliza Hoxha tha se "Ora e Pritjes" po shndërrohet

në një mesazh qytetar që po bashkon qytete anembanë Kosovës. "Nga Prishtina në Vushtrri dhe në çdo qytet të Kosovës, mesazhi është i njëjtë: Kosova po pret. Po presim drejtësi, liri dhe kthimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në atdhe.", tha Hoxha. Aktiviteti në Vushtrri është pjesë e fushatës "Kosova po pret", në kuadër të aktiviteteve të platformës "Liria ka Emër".



KËRKOHET PARABURGIM PËR BURRIN QË DYSHOHET SE VRAU GRUAN NË PRIZREN

PRIZREN, 27 GUSHT - Prokuroria Themelore në Prizren ka kërkuar që ndaj B.D., i dyshuar për vrasjen e bashkëshortes së tij, gjykata të shqiptojë masën e paraburgimit.

B.D., 81-vjeç, gjendet në ndalim prej 48 orësh, pasi më 26 gusht, pas mesnatës dyshohet se e vrau bashkëshorten e tij, L.D., në shtëpinë e tyre në Prizren. Prokuroria Themelore në Prizren dha detaje të tjera për ngjarjen, të cilësuar si vrasje e rëndë, duke theksuar se dorasi i dyshuar, pas ngjarjes, "ka tentuar të fshijë gjurmët e ngjarjes, dhe më pas ka njoftuar familjarët për rasti".

"Sipas kërkesës së Prokurorisë, më datë 26.08.2026, rreth orës 00:05, në Prizren, në shtëpinë e tij familjare, i dyshuari, B.D., pas një fjalosjeje me bashkëshorten e tij, viktimën me inicialet L.D., e ka sulmuar fizikisht atë, dhe e ka goditur dhe përplasur disa herë kokën e viktimës në tokë, me ç'rast ajo ka pësuar lëndime të shumta në kokë dhe pjesë të tjera të trupit. Si pasojë e lëndimeve të pësuar, viktimë ka ndërruar jetë në vendin e ngjarjes", u tha në njoftim të Prokurorisë. Policia në Prizren një ditë më parë tha se, sipas të dhënave të saj, çifti nuk kishte pasur raste



të mëhershme të dhunës së raportuar "dhe në momentin e incidentit kanë qenë vetëm në shtëpinë e tyre". Brenda kësaj jave, në Kosovë janë vrarë dy gra dhe dorasit e dyshuar janë bashkëshortët e tyre. Më 24 gusht, një grua shtatzënë

në Malishevë u vra dhe dorasi i dyshuar është bashkëshorti i saj, i cili është në gjendje kritike, pasi edhe ai ka pësuar plagë nga armët e zjarrit. Sipas të dhënave, nga viti 2010 e deri më tani, në Kosovë janë vrarë 63 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në disa raste, kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Nga Rrjeti i Grave të Kosovës kanë kërkuar që shteti të parandalojë dhunën ndaj grave, e jo të reagojë pas tragjedi. Institucionet, ndërkaq, janë


zotuar për zero tolerancë për rastet e dhunës ndaj grave. Më 2020, Kosova e ka miratuar Konventën e Stambollit të hartuar nga Këshilli i Evropës, duke e bërë pjesë të Kushtetutës së vendit. Ky instrument obligues detyron shtetet që ta luftojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Në bazë të konventës, parashihet që shteti të mbrojë viktimat duke u ofruar strehimore, të ndjekë penalisht dhunën ndaj grave, të gjitha institucionet shtetërore të bashkëpunojnë dhe të ketë mekanizma që monitorojnë nëse konventa zbatohet.

HAXHIU E KURTI PRESIN NË TAKIM LAMTUMIRËS SHEFEN E BE-SË NË KOSOVË, EVA PALATOVA

PRISHTINË, 27 GUSHT - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të enjten në takim lamtumirës shefen në detyrë të BE-së në Kosovë, Eva Palatova.

U.d. presidentja Haxhiu e falënderoi Palatovan për bashkëpunimin dhe angazhimin e saj gjatë shërbimit në Kosovë, si dhe vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për proceset e rëndësishme të vendit.

Gjatë takimit, u.d. presidentja Haxhiu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me Bashkimin Evropian dhe të avancimit të mëtejshme të



Kosovës në rrugën e saj evropiane. Ajo i uroi Palatovas suksese në angazhimet e saj të ardhshme.

Edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka pritur në takim shefen në detyrë të BE-së në Kosovë, Eva Palatova

"Herë si zëvendës shefe e herë si ushtruese e detyrës së shëfës së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, nga viti 2023 kemi pasur

takime të shpeshta e shkëmbime të shumta me znj. Eva Palatova. Në takimin lamtumirës, sot në Zyrën e Kryeministrit e falënderova për shërbimin dhe kontributin e saj në kultivimin e marrëdhënieve të mira e korrekte ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Krahas punës së institucioneve tona, është e rëndësishme që edhe Zyra e BE-së në kryeqytetin tonë të mbështesë aktivisht procesin e integritetit, ashtu që Kosovës t'i jepet statusi i vendit kandidat, i përcjell me një proces anëtarësimi të bazuar në meritë", ka shkruar Kurti në "Facebook".

"Pastrimi" drejt kompanive komunale, Rama: Secila komunë të mbajë përgjegjësi për territorin e saj

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë të ditur se është diskutuar mundësia që Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" të shndërrohet nga kompani rajonale në kompani komunale.

Rama ka thënë se për këtë çështje ka diskutuar me kryetarin e Lipjanit, Imri Ahmetin, kryetarin e Drenasit, Ramiz Lladrovcin, dhe nënkryetaren e Kryeqytetit, Besianë Musmurati. Sipas tij, kalimi në kompani komunale do të mundësonte menaxhim

më efikas dhe më të shpejtë të shërbimeve të pastrimit. "Aktualisht, në kompaninë regjionale 'Pastrimi' janë të përfshira Prishtina, Obiliqi, Lipjani, Fushë Kosova, Podujeva dhe Drenasi", ka deklaruar Rama.

Ai ka thënë se synimi është që secila komunë ta ketë kompaninë, ekipin dhe menaxhimin e vet, duke mbajtur përgjegjësi të plotë për pastrimin e territorit të saj. Rama bëri të ditur se Obiliqi dhe Fushë Kosova tashmë kanë nisur procedurat për këtë

ndryshim, ndërsa me kryetarët e Lipjanit dhe Drenasit është diskutuar për vazhdimin e përbashkët të iniciativës. "Kjo nuk është çështje politike. Është çështje e përgjegjësisë ndaj qytetarëve dhe e një shërbimi jetik që duhet të funksionojë çdo ditë", ka theksuar Rama.

Ai ka paralajmëruar se në takimin e radhës pritet të marrin pjesë edhe kryetarët e komunave të tjera të përfshira në "Pastrimi", me qëllim që të gjendet një zgjidhje e përbashkët për menaxhimin e shërbimeve të pastrimit.



Këshilli Gjyqësor i kërkon Haxhiut t'i lirojë nga detyra gjyqtarët e dorëhequr serbë

PRISHTINË, 27 GUSHT - Në vazhdim të takimit të 371- të me radhë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është shqyrtuar kërkesa për tërheqjen e dorëheqjeve të gjyqtarëve dhe

stafit mbështetës nga komuniteti serb. Me këtë rast pas trajtimit dhe shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, me shumicë votash KGJK-ja ka vendosur

që të refuzohet kërkesa për tërheqjen e dorëheqjeve të gjyqtarëve dhe ka vendosur që t'i propozojë presidentes së Republikës së Kosovës lirim nga detyra të

gjyqtarëve. Po ashtu, KGJK-ja autorizoi Sekretariatit që të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale për lirim nga detyra të stafit mbështetës.



IQMT NË AKSION: GJOBITJE DHE MASA NDËSHKUESE NDAJ UDHËRRËFYESVE TURISTIKË PA LICENCË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 GUSHT - Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-074 për Turizmin dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2024 për kushtet, kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së udhërrëfyesve turistikë, Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT) po realizon mbikëqyrjen e veprimtarisë së udhërrëfyesve turistikë në Republikën e Kosovës.

Gjatë ditës së sotme, inspektimet janë duke u zhvilluar në regjionet e Prizrenit, Prishtinës dhe Obiliqit, me qëllim të parandalimit dhe evidentimit të ushtrimit të paligjshëm të veprimtarisë së udhërrëfyesve turistikë pa licencë.

Në kuadër të mbikëqyrjes, është evidentuar angazhimi i udhërrëfyesve jo-vendas nga kompani të ndryshme turistike të vendeve të rajonit, të cilët, në rastet kur veprojnë pa licencën e nevojshme, janë në kundërshtim

me dispozitat ligjore në fuqi. Përveç aspektit ligjor, angazhimi i personave të palicencuar mund të ndikojë edhe në mënyrën e prezantimit të historisë, trashëgimisë kulturore dhe vlerave reale të lokacioneve turistike që vizitohen në Republikën e Kosovës.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, përmes IQMT-së, mbetet e përkushtuar në mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie dhe do të ndërmarrë masat përkatëse ndaj operatorëve turistikë, personave juridikë, bizneseve individuale dhe personave fizikë që ushtrojnë ose mundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik pa licencë dhe në kundërshtim me ligjin e Turizmit.

Ushtrimi i veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik në kundërshtim me dispozitat ligjore përbën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë prej 3,000 deri në 9,000 euro.

IQMT u bën thirrje të gjithë



operatorëve turistikë që angazhimin e udhërrëfyesve ta bëjnë në mënyrë të ligjshme, duke respektuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara. Në të kundërtën, ndaj subjekteve që konstatohet se veprojnë në kundërshtim me ligjin do të ndërmerren masat ndëshkuese përkatëse.

Republika e Kosovës posedon vlera të rëndësishme historike, kulturore dhe turistike. Për këtë arsye, vizitorët duhet të marrin informacione të sakta, profesionale dhe të besueshme për vendet që vizitojnë, nga persona të përgjegjshëm dhe të licencuar.

Kosova ka udhërrëfyes turistikë vendorë të licencuar dhe profesionalë. IQMT inkurajon kompanitë turistike që t'i angazhojnë udhërrëfyesit vendorë të licencuar, duke kontribuar kështu në informimin e drejtë të vizitorëve, respektimin e legjislacionit dhe promovimin e denjë të trashëgimisë dhe vlerave turistike të Republikës së Kosovës.

ZKA: MASAT PËR FUQIZIMIN E GRAVE NUK KANË SIGURUAR PËRFAQËSIM TË KËNAQSHËM NË POZITA UDHËHEQËSE DHE VENDIMMARRËSE

PRISHTINË, 27 GUSHT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Fuqizimi i rolit të grave në udhëheqje dhe marrje të vendimeve" për periudhën 2020 - 2024.

Rezultatet e auditimit tregojnë se institucionet publike nuk kanë arritur të sigurojnë rritje të kënaqshme të përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse.

Ndonëse është shënuar progres në përfshirjen e grave në shërbimin civil ku gjatë periudhës së audituar 2020 - 2024, ato përbënin 42% të të punësuarve në shërbimin civil, megjithatë nga 1,459 pozita drejtuese prej tyre 988



mbaheshin nga burrat dhe 471 gratë. Kjo tregon se rritja e pjesëmarrjes së grave në shërbimin civil nuk është reflektuar në të njëjtën masë në pozitat vendimmarrëse.

Auditimi ka konstatuar se

objektivat për barazi gjinore nuk janë shndërruar mjaftueshëm në masa konkrete dhe të monitorueshme në menaxhimin e burimeve njerëzore. Masat afirmative janë trajtuar kryesisht si mundësi ligjore që mund të

përdoret në raste të veçanta dhe jo si instrument aktiv për adresimin e nën-përfaqësimit të grave. Edhe zhvillimi profesional nuk është orientuar mjaftueshëm drejt përgatitjes dhe mbështetjes së grave për avancim në karrierë. Mangësi janë evidentuar edhe në regjistrimin, përditësimin dhe raportimin e të dhënave sipas gjinisë, si dhe në koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Kjo ka kufizuar analizën e përfaqësimit gjinor, monitorimin e progresit dhe planifikimin e masave për rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Lidhur me këtë auditim,

Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, vlerësoi se rritja e pjesëmarrjes së grave në shërbimin civil duhet të reflektohet edhe në pozitat vendimmarrëse.

Spanca theksoi nevojën që institucionet ta shndërrojnë barazinë gjinore nga një parim i përgjithshëm në veprime konkrete, të zbatueshme dhe të monitorueshme, duke përdorur më aktivisht masat afirmative, zhvillimin profesional dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë.

Me qëllim të përmirësimit të përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë gjashtë rekomandime për institucionet përgjegjëse.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës zgjedh Afërdita Bytyqi zëvendëskryesuese

Prishtinë, 27 gusht - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në takimin e 371-të me radhë, ka zgjedhur gjyqtaren e Gjykatës së Apelit, njëherësh anëtare e KGJK-së, Afërdita Bytyqi, në

pozitën e zëvendëskryesueses të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Para anëtarëve të Këshillit, zëvendëskryesuesja Bytyqi ka shprehur falënderim për

besimin e dhënë dhe është zotuar që do të bashkëpunoj dhe të kontribuoj me gjithë kapacitetin në drejtim të avancimit të sistemit të drejtësisë për një Këshill

Gjyqësor më të avancuar dhe më transparent.

Mandati i saj si zëvendëskryesuese fillon me datë 27 gusht 2026, me mandat trevjeçar.



Qeveria në detyrë zhvillon mbledhje elektronike, miraton transferimin e mbi 5.6 milionë eurove

Prishtinë, 27 gusht - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës ka zhvilluar një mbledhje elektronike, në të cilën ka marrë disa vendime dhe ka miratuar kërkesa për transferimin e mjeteve financiare.

Në këtë mbledhje, Qeveria ka miratuar vendimin për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike

Qendrore “Korporata e Ruajtjes së Energjisë - KRE (Energy Storage Corporation - ESCorp)” Sh.A.

Po ashtu, është miratuar vendimi për dhënie në shfrytëzim të hapësirës në parcelën kadastrale P-9012-0, me sipërfaqe prej 999 metrash katrorë, në pronësi të Agjencisë Pyjore të Kosovës - Ndërmarrja e Pyjeve në Prizren, për nevojat e Ministrisë së Drejtësisë.

Në kuadër të vendimeve financiare, Qeveria ka miratuar kërkesën e Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës për transferimin e 4,333,900 eurove, për furnizim me barna nga Lista e Barnave Esenciale.

Gjithashtu, është miratuar kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për transferimin e 1 milion eurove, për mbulimin e obligimeve që lidhen me

shpenzimet operative.

Qeveria ka miratuar edhe kërkesën e Komunës së Podujevës për transferimin e 300 mijë eurove, për mbulimin e obligimeve kontraktuale. Ndërkaq, në këtë mbledhje është miratuar edhe vendimi për nominimin e tre përfaqësuesve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Këshillin Konsultativ për Komunitete.



Në total, vendimet e miratuara për transferimin e mjeteve kapin shumën prej 5.633.900 eurosh.

AUV URDHËRON TËRHEQJEN NGA TREGU TË QUMËSHTIT UHT LAND 3.2%, PËR SHKAK TË MYKOTOKSINËS

Prishtinë, 27 gusht - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) njoftoi të mërkurën se ka urdhëruar tërheqjen e “menjëhershme” të qumështit UHT Land 3.2% nga tregjet e Kosovës, duke thënë se është vërtetuar se ai përmban substancë të rrezikshme toksike.

AUV tha se është njoftuar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut se ato kanë gjetur aflatoksinë M1 mbi nivelin e lejuar në qumështin UHT Land 3.2%, të prodhuar nga qumështorja VITA në Kosovë. “Në përputhje me Ligjit për Ushqim, sipas të cilit ushqimi konsiderohet i dëmshëm dhe jo i sigurt për njerëzit kur përmban mykotoksinë mbi kufirin e lejuar, AUV ka urdhëruar tërheqjen e menjëhershme nga tregu të qumështit UHT Land 3.2%, të identifikuar si të prekur dhe ka filluar kontrollin zyrtar dhe verifikimin e gjurmueshmërisë”,

thuhet në njoftim.

AUV shtoi se në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë, do të përcaktojë masat e mëtejshme lidhur me qumështoren VITA.

Qumështorja VITA nuk iu përgjigj thirrjeve të Radios Evropë e Lirë (REL) për koment. Lajmi vjen pasi Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AFV) e Maqedonisë së Veriut tha të martën se javën e kaluar i kishte shkatërruar dy ngarkesa me qumësht UHT të importuara nga Kosova, për shkak të pranisë së aflatoksinës mbi përqendrimet maksimale të lejuara me rregulloret ligjore. Përkrahësit e përgjithshme të qumështit të shkatërruar ishte 27.520 kilogramë, tha AFV. “Sasitë e pasigurta të qumështit, të cilat ishin të destinuara për shpërndarje në një rrjet supermarketesht në vend, u shkatërruan pa rrezik javën e



kaluar në deponinë e Drisllës nën mbikëqyrjen e një veterineri zyrtar”, tha ajo.

AFV nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it për më shumë hollësi rreth gjetjeve të saj.

Aflatoksina në qumësht është një toksinë që mund të shfaqet kur lopët ushqehen me misër, drithëra ose ushqim të ruajtur

që është ndotur me myk, kryesisht nga kërpudhat *Aspergillus flavus* dhe *Aspergillus parasiticus*.

Aflatoksina B1 (AFB1) gjendet kryesisht në ushqimin e kafshëve. Kur lopa e ha një ushqim të ndotur me myk, një pjesë e saj shndërrohet në aflatoksinë M1, që autoritetet maqedonase

thanë se e gjetën në qumështin e importuar nga Kosova.

Ndërkohë, kjo nuk është hera e parë në kohët e fundit që autoritetet kosovare e urdhërojnë kompaninë Vita të tërheqë produkte nga raftet e marketeve në vend.

Në fillim të muajit, AUV e urdhëroi atë t'i tërheqë nga tregu 12 produkte, duke thënë se, në ato produkte që janë paraqitur se kanë përmbajtje shtazore, ishte gjetur prani e vajit të palmës, qumështit pluhur dhe niseshtesë së padëkluar.

Paraprakisht, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, kishte njoftuar për tërheqjen nga tregu të disa produkteve të qumështit nga kompani të tjera.

Kompania ndërkaq, publikoi disa rezultate, që pretendoi se vërtetojnë se në qumështin e saj nuk ka vaj palme.

DAUT HARADINAJ KËRKON REAGIM URGJENT PËR SEKTORIN E QUMËSHTIT: MASAT PO E PARALIZOJNË INDUSTRIJË

Prishtinë, 27 gusht - Zyrtari i lartë i Aleancës, Daut Haradinaj, ka kërkuar reagim urgjent të institucioneve për situatën në sektorin e qumështit, duke paralajmëruar për pasoja të rënda për prodhuesit vendorë, fermerët dhe konsumatorët.

Haradinaj ka thënë se sektori i qumështit është një nga shtyllat kryesore të bujqësisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe se institucionet duhet të krijojnë kushte për zhvillimin e prodhimit vendor dhe eksportit.

Sipas tij, mbrojtja e konsumatorit dhe etiketimi korrekt janë të domosdoshme, por masat ndaj prodhuesve duhet të jenë proporcionale dhe të bazuara



në ligj, në rastet kur produktet janë të deklaruar qartë dhe i plotësojnë standardet. “Prodhuesit vendorë po për-

ballen me një situatë shumë të rëndë”, ka shkruar Haradinaj, duke pretenduar se masat e ndërmarra nga institucionet

dhe agjencitë përgjegjëse po e paralizojnë industrinë e qumështit.

Ai ka theksuar se pasojat po vërehen edhe në treg, ku në disa markete, sipas tij, janë krijuar mungesa të produkteve, ndërsa disa linja të prodhimit janë ndalur. Haradinaj ka thënë se, në të njëjtën kohë, kompanitë vazhdojnë të kenë shpenzime për paga, energji, kredi dhe obligime ndaj fermerëve.

Haradinaj e ka cilësuar si veçanërisht shqetësuese faktin që masat po zbatohen gjatë muajit gusht, kur prodhimi dhe grumbullimi i qumështit janë në kulm.

Sipas tij, kjo mund të ndikojë në të gjithë zinxhirin e

furnizimit dhe të dëmtojë fermerët, përpunuesit dhe konsumatorët.

Daut Haradinaj ka ngritur shqetësimin edhe për vështirësitë që prodhuesit vendorë vazhdojnë t'i kenë në eksport, ndërsa tregu i Kosovës mbetet i hapur për produkte të importuara.

Në fund, ai u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse që të zhvillojnë dialog me industrinë dhe të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme që, sipas tij, do të mundësojnë mbrojtjen e konsumatorit dhe njëkohësisht të prodhuesit vendor. “Një industri e fortë e qumështit është në interes të gjithë Kosovës”, ka përfunduar Haradinaj.

“Pastrimi” paralajmëron qytetarët: 500 euro gjobë për hedhjen e mbeturinave

Prishtinë, 27 gusht - Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” ka njoftuar se gjatë mbrëmjes së kaluar ka larguar sasi të mëdha të mbeturinave vëllimore dhe inerte nga disa

lagje të kryeqytetit.

Përmes një postimi në “Facebook”, kompania u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos hedhin mbeturina në hapësirat publike, duke paralajmëruar

masa ndëshkuese. “Ju lusim qytetarë, të keni kujdes, mos hidhni mbeturina në hapësira publike, sepse do të gjobiteni 500 euro nga Inspektorati i Komunës”, thuhet në njoftimin e

kompanisë.

“Pastrimi” ka apeluar te qytetarët që të tregojnë përgjegjësi dhe të kontribuojnë në ruajtjen e pastërtisë së hapësirave publike në kryeqytet.



A PO E FITON TRUMP TANI LUFTËN ME IRANIN?



Për muaj me radhë, lufta me Iranin dukej si një dështim: goditje spektakolare në fillim, por pa rrëzim të regjimit dhe madje me mbylljen e ngushticës së Hormuzit, gjë që e tronditi ekonominë botërore. Për një periudhë, Trump dukej se ishte i gatshëm të pranonte edhe marrëveshjen më të dobët të mundshme. Por në korrik ai kreu sërish sulme ajrore për 13 ditë radhazi – ndoshta me një rezultat më të mirë nga sa dukej deri tani. Shumë njerëz i kishin vlerësuar sulmet amerikane të korrikut si të zhurmshme, por të kujdesshme dhe pa rezultate – në fund të fundit, SHBA-ja nuk kishte goditur objektiva me rëndësi strategjike. Dyshimi ishte: Trump dëshiron t'i rikthejë iranianët në tryezën e negociatave. Por ekziston edhe një interpretim tjetër: pas sulmeve nuk kishte hezitim, por një vendim të

ndërgjegjshëm për të çaktivizuar sistemet e radarëve dhe sensorët me të cilët regjimi iranian kontrollon ngushticën e Hormuzit.

Nafta po kalon sërish përmes ngushticës së Hormuzit

Në fakt, amerikanët pretendojnë se klerikët iranianë kanë më pak kontroll mbi ngushticën e Hormuzit. Sipas tyre, çdo ditë 15 deri në 20 cisterna naftë kalojnë përmes ngushticës – pa qenë në gjendje që klerikët iranianë të bëjnë diçka vendimtare kundër tyre. Sipas presidentit amerikan Trump, deri në 10 milionë fuçi naftë kalojnë gjatë natës – rreth gjysma e sasisë që transportohet çdo ditë përmes ngushticës para

luftës.

Të martën, Trump deklaroi gjithashtu se marina amerikane kishte pastruar ose kishte shpërthyer të gjitha minat në ujërat ndërkombëtare të ngushticës së Hormuzit. Irani ishte informuar se çdo anije ose varkë që do të vendoste mina të reja do të shkatërrohej menjëherë, tha Trump.

Ekonomia iraniane është në gjendjen më të keqe ndonjëherë

Të hënën, sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, njoftoi një ofensivë të re në frontin ekonomik dhe e quajti atë një "D-Day ekonomik" dhe "fazën përfundimtare" të luftës. Regjimi iranian duhet, në kuadër të një operacioni të ri të quajtur "Economic Outcast" ("i

përgjashtuar ekonomikisht"), të detyrohet të bëjë lëshime – ose të rrëzohet.

Në një shkrim në Financial Times, Bessent tha se ekonomia e Iranit "nuk ka qenë kurrë kaq e dobët" sa tani, ndërsa inflacioni është njëkohësisht ndër më të lartët e regjistruar ndonjëherë.

Edhe pse administrata Trump, me sanksionet e reja, nuk guxon të vërë në shënjestër edhe Kinën për shkak të tregtisë së saj me Iranin, riali iranian ra në nivelin më të ulët të të gjitha kohërave pas njoftimit.

Optimistët për luftën me Iranin, si Mark Dubowitz nga instituti kërkimor FDD, besojnë se regjimi iranian do të shembet në periudhën afatmesme.

Udhëheqësit në Teheran, shkruan ai në X, e dinë tashmë për krizën ekzistenciale të regjimit – dhe se miliona iranianë mund të dalin përsëri në rrugë.

Por skeptikët paralajmërojnë

Instituti amerikan 'Institute for the Study of War' përpaket ta zbusë këtë entuziazëm. Sipas tij, nuk ka shenja se presioni ekonomik ka ndryshuar qëndrimin refuzues të vijës së ashpër në Teheran.

Edhe më qartë paralajmëron analisti izraelit Danny Citrinowicz nga instituti INSS, i cili më parë kishte kritikuar kursin e luftës.

Sa më shpesh që përfaqësuesit e qeverisë amerikane të flasin publikisht për rrëzimin e regjimit, aq më shumë kjo e forcon dyshimin e klerikëve iranianë se Uashingtoni në të vërtetë nuk dëshiron një marrëveshje, por fundin e Republikës Islamike.

Nëse nuk ekziston një rrugëdalje diplomatike, atëherë nxitja nuk është kapitullimi, por përshkallëzimi i konfliktit.

Katër skenarë për trupat në Europë, Pentagoni vendos të tavolinë të ardhmen e pranisë ushtarake

Pentagoni po përgatit të paktën 4 skenarë për të ardhmen e pranisë ushtarake amerikane në Europë. Sipas një dokumenti të siguruar nga Reuters, këto opsione do t'i paraqiten Sekretarit të Mbrojtjes Pete Hegseth deri më 6 nëntor në kuadër të rishikimit të pranisë së forcave amerikane në kontinent. Rishikimi, i shpallur në qershor dhe që pritet të përfundojë në dhjetor, ka ngritur shqetësime mes aleatëve europianë të NATO-s, të cilët u druhen një reduktimi të shkallës së gjerë të rreth 80

mijë trupave amerikane të dislokuara në Europë, si ndëshkim për qëndrimin e aleatëve në luftën me Iranin. Dokumenti nuk sqaron se cilët janë konkretisht katër skenarët, por një zyrtar i lartë i Pentagonit ka deklaruar se administrata po shqyrton një gamë të gjerë opsionesh, që variojnë nga ruajtja e pranisë aktuale deri te reduktimi i forcave dhe ndryshimi i dislokimit të tyre. Në vlerësim do të merret parasysh edhe kontributi i aleatëve. Pentagoni do të shqyrtojë shpenzimet e tyre



për mbrojtjen, kapacitetet ushtarake dhe gatishmërinë për t'u ofruar forcave amerikane akses në baza dhe hapësirë ajrore.

Administrata Trump ka kërkuar vazhdimisht që vendet europiane të marrin një pjesë më të madhe të përgjegjësisë për sigurinë e kontinentit.

Sipas Reuters, përgjigjet e aleatëve ndaj një pyetësi të Pentagonit pritet të ndihmojnë në përcaktimin e skenarëve që do të shqyrtohen përfundimisht nga Sekretari i Mbrojtjes.

SHEMBJA E AKULLNAJËS DYSHOHET SE SHKAKTOI PËRMBYTJEN VDEKJEPRURËSE NË KUFIRIN NEPAL-TIBET

Të paktën 177 persona kanë humbur jetën nga përmbytja e menjëhershme. Shkencëtarët ngrenë alarmin për shkrirjen e shpejtë të akullnajave në Himalaje. Një shembje akullnaje dyshohet se shkaktoi përmbytjen e fuqishme që goditi zonën kufitare mes Nepalit dhe Tibetit, duke shkaktuar të paktën 177 viktima dhe duke lënë mbi 1,300 persona

akullnajave në Universitetin e Dundee-t, ekipi i tij ka identifikuar shembjen e pjesës së poshtme të një akullnaje pranë majës Langtang Lirung, rreth 15 kilometra në perëndim të zonës së prekur nga përmbytjet. Sipas tij, masa e shembur ka lëvizur fillimisht drejt veriperëndimit dhe më pas në drejtim të perëndimit, duke

Shkencëtarët paralajmërojnë për ndryshimet klimatike

Shkaku i saktë i shembjes së akullnajës ende nuk është përcaktuar. Megjithatë, shkencëtarët kanë paralajmëruar prej vitesh se temperaturat po rriten dhe ndryshimet klimatike po



krahasuar me vitin 2000. Ekspertët paralajmërojnë se kjo situatë mund të shtojë rrezikun e përmbytjeve, rrëshqitjeve të dheut, shembjeve të akullnajave dhe shpërthimeve të liqeneve akullnajore. “Me ngrohjen e planetit, akullnajat po tkurren dhe shkrirja e borës po rritet. Edhe permafrost-i, i cili ndihmon në mbajtjen e qëndrueshme të disa shpateve malore, po ngrohet, po shkrirhet

dhe po degradohet”, shpjegon Dr Cook. Sipas tij, kjo mund të sjellë më shumë rrëshqitje dheu, rrjedha mbetjesh, ujëra nga shkrirja e akullnajave, shpërthime të liqeneve akullnajore dhe shembje të akullnajave.

Ekspertët theksojnë se është e vështirë të përcaktohet nëse një ngjarje e vetme është shkaktuar drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike. Megjithatë, rritja e numrit të këtyre fenomeneve në zonat malore po shihet si një sinjal gjithnjë e më shqetësues i ndikimit të ngrohjes globale.

Ngjarje të ngjashme janë regjistruar vitet e fundit edhe në Indi, Zvicër dhe Itali. Në vitin 2021, shembja e një pjese të madhe të një akullnajeje në luginën Chamoli, në veri të Indisë, shkaktoi një valë masive uji dhe mbetjesh, duke vrarë rreth 200 njerëz.

të zhdukur.

Raportimet e para sugjerorin se një tërmet kishte shkaktuar një rrëshqitje dheu, e cila më pas kishte sjellë përmbytjen. Por Shërbimi Gjeologjik i SHBA-së (USGS) sqaroi se bëhej fjalë për një “shembje akullnajeje”, pra shpërbërjen dhe rënien e një akullnajeje ose të një pjese të saj. Fuqia e përplasjes së masës së akullit dhe shkëmbinjeve me fundin e luginës ishte aq e madhe, sa ngjarja u regjistrua si një lëkundje me magnitudë 5.2.

Akulli dhe shkëmbinjtë u përplasën në lumë

Sipas Dr Simon Cook, ekspert i

ndjekur rrjedhën e lumit.

Ndërkohë, një analizë e Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillimin e Integruar Malor (ICIMOD) sugjeron se mund të ketë ndodhur një ortek akulli dhe shkëmbinjtë nga një zonë me lartësi të madhe. Masa të mëdha akulli dhe mbetjesh shkëmbore përfunduan në lumin Lende Khola, degë e Bhote Koshi-t. Kjo shkaktoi një rritje të menjëhershme të prurjeve, duke transportuar ujë, sedimente dhe gurë të mëdhenj në drejtim të zonave më të ulëta.

Niveli i ujit në lumenjtë në rrjedhën e poshtme u rrit me 7 deri në 9 metra brenda vetëm 30 minutash, ndërsa disa stacione monitorimi u dëmtuan ose u shkatërruan.

përshejtojnë shkrirjen e akullnajave dhe të permafrost-it në Himalaje. Sipas një analize të ICIMOD, akullnajat në rajonin Hindu Kush-Himalaje po humbasin akull me një ritëm rreth dy herë më të lartë





Superliga, dy ndeshje të fundjavës luhen në mbrëmje

PRISHTINË, 27 GUSHT - Për herë të parë në Superligën e Kosovës në futboll, dy ndeshje të xhiros së njëjtë, do të zhvillohen në mbrëmje, ka njoftuar Federata e Futbollit të Kosovës (FFK). FFK-ja ka publikuar orarin e ndeshjeve

të xhiros së tretë të Superligës, e cila nis sot (e premte) dhe mbyllet të dielën në mbrëmje. Megjithatë, ajo që bie në sy në këtë orar është se dy ndeshje do të luhen nën dritën e reflektorëve, pra në mbrëmje, njëra të nesër (e shtunë) dhe

tjetra pasnesër (e diel). Të shtunën nga ora 19:00, Gjilani do ta pres Dukagjinin kurse të dielën në orën e njëjtë do të nis përballja ndërmjet Prishtinës dhe Llapit. Deri më tani, në dy xhirot e para të këtij sezoni, janë zhvilluar vetëm dy

ndeshje në mbrëmje, njëra në Prishtinë dhe tjetra në Klinë. Ndërkohë, përballjet tjera të xhiros së tretë dhe që nisin në orën 16:30, janë Drenica - Ballkani të premten, Feronikeli '74 - Malisheva të shtunën dhe Vushtrria - Drita të dielën.



SERBIA TËRHEQ EKIPI 3⇄3, SHMANGET PËRBALLJA ME KOSOVËN

TARANTO, 27 GUSHT - Serbia ka vendosur ta tërheqë ekipin e saj nga gara e basketbollit 3x3 në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026", duke bërë që të mos zhvillohet përballja e planifikuar me Kosovën. Organizatorët kanë njoftuar për ndryshime në orarin e garave pas tërheqjes së Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut nga turneu i basketbollit 3x3. Për shkak të këtyre ndryshimeve, orari i

mëparshëm i transmetimeve është zëvendësuar me një version të ri. Tërheqja e Serbisë ka marrë vëmendje të veçantë në Kosovë, pasi të dyja përfaqësueset ishin shortuar në të njëjtin grup dhe duhej të përballleshin më 29 gusht. Megjithatë, deri tani nuk është dhënë ndonjë arsye zyrtare që tërheqjen e Serbisë ta lidhë drejtpërdrejt me Kosovën. Pavarësisht kësaj,

vendimi ka ngritur pikëpyetje për shkak të kohës dhe rrethanave në të cilat është marrë. Serbia edhe në të kaluarën ka shmangur përballjet me Kosovën në disa gara sportive, ndërsa në raste të tjera ka kërkuar që shorti të mos i vendoste dy përfaqësueset në të njëjtin grup. Me tërheqjen e ekipit serb, ndeshja Kosovë-Serbi në basketbollin 3x3, e paraparë për 29 gusht, nuk do të zhvillohet.



MURIQI E DËRGON FENERBAHÇEN NË LIGËN E KAMPIONËVE

LYON, 27 GUSHT - Vedat Muriqi ishte protagonist në suksesin e madh të Fenerbahçes, që ka siguruar kualifikimin në fazën e ligës së Ligës së Kampionëve pas fitores ndaj Lyonit. Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës e ka zhbllokuar ndeshjen në minutën e 24-t, duke i dhënë Fenerbahçes epërsinë 1:0. Vetëm katër minuta më vonë, Brown ka shënuar edhe golin e dytë për skuadrën turke. Lyoni ka reaguar në pjesën e dytë, duke ngushtuar rezultatin në 2:1 me Fofanan në minutën e 61-të. Francezët kanë tentuar ta barazonin rezultatin, por dy gola të tyre janë anuluar për pozicion jashtë loje. Me këtë rezultat, Fenerbahçe ka siguruar pjesëmarrjen në



fazën e ligës së Champions League, ndërsa Lyoni do të vazhdojë garat evropiane në Ligën e Evropës.

Pas ndeshjes, Vedat Muriqi ka folur për rëndësinë e këtij kualifikimi dhe emocionet për rikthimin e Fenerbahçes në

elitën e futbollit evropian. "Është nder dhe burim i krenarisë për ne që ta dëgjojmë himnin e Ligës së Kampionëve në 'Kadikoy' pas gjithë këtyre vjetëve", ka thënë Muriqi pas ndeshjes për faqen zyrtare të klubit. Muriqi ka vlerësuar edhe unitetin e skuadrës, duke theksuar se lojtarët kishin besuar në kualifikim dhe kishin luftuar deri në fund. "Jemi shumë të lumtur. Në fjalën që kemi dhënë para ndeshjes kemi besuar se, me dëshirën e Zotit, do të kemi paraqitje të mirë dhe do të kualifikohemi në Ligën e Kampionëve. Jemi bashkuar pas ndeshjes me Konyasporin. Ajo fitore rriti moralin tonë. Kemi pasur unitet të pabesueshëm. Përkundër kohës së shkurtër,

kemi luftuar fort", është shprehur Muriqi. Ai ka theksuar se përvoja dhe profesionalizmi ishin të rëndësishme për skuadrën në një ndeshje me shumë presion. "Jemi munduar të lëmë anash emocionet. Jemi profesionistë, jemi me përvojë. Nuk duhet të shikosh në ndeshje me emocione", ka thënë reprezentuesi i Kosovës. Muriqi ka folur edhe për rolin e fatit në futboll, duke e cilësuar kualifikimin si një moment të veçantë për klubin dhe tifozët. "Por ndonjëherë edhe fati është i rëndësishëm në futboll. Jemi të gjithë të lumtur dhe krenarë. Është dhuratë për gjithë komunitetin e Fenerbahçes, tifozët dhe gjithë Turqinë", ka thënë Muriqi.

Sermaxhaj largohet nga posti i selektorit të Kosovës

Prishtinë, 27 gusht - Sami Sermaxhaj nuk do të jetë më selektor i Kombëtares së Kosovës në futboll për femra. Largimin e tij nga kjo pozitë e ka bërë me dije vetë Sermaxhaj të enjten, përmes një postimi në rrjetet sociale. Ai ka falënderuar Federatën e Futbollit të Kosovës dhe

presidentin e saj, Agim Ademi, për mbështetjen dhe besimin gjatë periudhës së tij si selektor. Sermaxhaj ka shprehur mirënjohje edhe për stafin e tij dhe futbollistët e Kombëtares, duke vlerësuar përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre. "Puna me to ishte kënaqësi e jashtëzakonshme dhe privilegj

shumë i madh për mua. Jam krenar për përkushtimin, profesionalizmin dhe shpirtin e tyre luftarak, si brenda ashtu edhe jashtë fushës", ka shkruar Sermaxhaj. Sermaxhaj e kishte marrë drejtimin e Kombëtares së Kosovës për femra në tetor të vitit 2024, ndërsa pas largimit

nga posti i selektorit pritet të rikthehet në futbollin e klubeve. Sipas raportimeve, Sermaxhaj mund ta marrë drejtimin e Ballkanit të Suharekës, pasi klubi i ka dhënë fund bashkëpunimit me trajnerin kroat Mislav Karoglan. Nëse marrëveshja realizohet,



Sermaxhaj do të rikthehet në futbollin e klubeve, këtë herë në krye të një prej skuadrave kryesore të Superligës së Kosovës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "J&N Construction" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 812221456 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "J&N Construction" D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nr. 812221456 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "J&N Construction" L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812221456 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Njoftim për rritje kapitali
nga 'HAK BAU' Sh.PK

"Hak Bau" Sh.PK me seli në Gjakovë, bënë rritjen e kapitalit të SH.PK-së me numër unik identifikues NUI: 812452382, të leshuar nga ARBK.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Trim Rezniciq shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të leshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u "Ahmet Rrustemi" Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

